



**Kolegji AAB**

# **RREGULLORE PËR GRANTE**

Prishtinë, Tetor 2024

Në bazë të nenit 16 të Statutit, nenit 4 të Rregullores së Punës të Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues me datën 21/10/2024 miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR GRANTE**

### **Dispozita të Përgjithshme**

#### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është mbështetja e punës kërkimore dhe shkencore/artistike të stafit të rregullt akademik të Kolegjit AAB përmes granteve dhe mbështetjes financiare.
2. Kjo rregullore përcakton kriteret për përfitim të granteve dhe të mbështetjes financiare të punës kërkimore dhe shkencore/artistike të stafit të rregullt akademik.

#### **Neni 2**

2. Në kuptim të kësaj rregullore, puna kërkimore dhe shkencore/artistike e stafit të rregullt akademik e cila mbështetet financiarisht është:
  - pjesëmarrja në konferenca të karakterit shkencor/artistik;
  - pjesëmarrja në simpoziume të karakterit shkencor/artistik;
  - publikimi i punimeve shkencore/artistike në databaza të njohura shkencore/artistike;

#### **Neni 3**

1. Të drejtë aplikimi për grante dhe mbështetje financiare për punën kërkimore dhe shkencore/artistike kanë të gjithë stafi i rregullt<sup>1</sup> akademik i Kolegjit AAB.
2. Procedura e dhënies së granteve apo financimit të punës kërkimore dhe shkencore/artistike bëhet në bazë të kërkesës së stafit të rregullt akademik, vetëm pasi që:
  - a. emri/abstrakti i autorit të jetë indeksuar në platformën Clarivate Analytics (Web of Science) në koleksionin bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo SCOPUS;
  - b. revista/botuesi të mos jenë në lista të dyshimta apo në fazë komercializimi<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Staf i rregullt akademike në kuptim të kësaj rregulloreje për të fituar të drejtën e aplikimit dhe përfitim të granteve janë mesimdhënësit të cilët kanë së paku gradën shkencore Dr.sc. ose kanë thirrje akademike.

<sup>2</sup> Fazë komercializimi konvencionalisht konsiderojmë kur një revistë indekskon disa herë më shumë abstrakte në Scopus se një vit paraprak. Zakonisht këto revista në fund të vitit ose muajt e parë të vitit në vazhdim, hiqen nga Scopus dhe madje fshihen edhe punimet tashmë të indeksuara nga viti paraprak.

3. Staf i rregullt akademik mund të jetë përfitues i granteve apo mbështetjes financiare për tre punime të publikuar brenda një viti kalendarik, apo tri herë për vit kalendarik kur përfiton edhe për konferenca shkencore.

4. Autori nuk mund të aplikojë për punimet e publikuara dy vite më herët.

#### Neni 4

#### Grantet për publikime shkencore

1. Publikimet shkencore (të kategorisë artikull & rishikim)<sup>3</sup> të ranguar në Clarivate Analytics (Web of Science) në koleksionin bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo SCOPUS, duke përjashtuar revistat e dyshimta<sup>4</sup>, përkrahen financiarisht në formë të granteve.

2. Të drejtë aplikimi për përfitim financiar për publikime shkencore sipas kësaj rregulloreje ka vetëm autori i parë.

3. Kur një autor publikon si i vetëm në revista të ranguar në Clarivate Analytics (Web of Science) në koleksionin bërthamë (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo Scopus (Q1 deri Q4), duke përjashtuar revistat e dyshimta, financohet siç është paraparë në tabelë për autorin e parë.

4. Kur një autor publikon bashkë me autorin e dytë/korrespondent i cili është staf i rregullt, atëherë autori i parë përfiton grant shtesë siç është paraparë në tabelë për autorin e dytë/korrespondentë, vetëm për punimet e publikuara në revistat shkencore që janë të indeksuara në Scopus (Q3 dhe Q4).

5. Një autor ka të drejtë në përkrahje financiare për publikime shkencore, deri maksimum tri (3) herë brenda një viti kalendarik.

6. Kur një autor aplikon për përkrahje për herën e katërt apo më shumë, atëherë punimi duhet të jetë i publikuar në revistën të ranguar në Q1, Q2 ose Q3 sipas SCOPUS apo Clarivate (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe të mos jetë në listën e botuesve apo revistave të dyshimta e jorelevantë të cilën e harton Kolegji AAB dhe që parashihen me manual të veçantë të nxjerrë nga Këshilli për Shkencë dhe të aprovuar nga Senati.

---

<sup>3</sup> Grantet jepen vetëm për dy kategori, të cilat konsiderohen si: a. article (njihen edhe si original article, research article dhe, b. review (njihet edhe si review article, essays). Nuk mbështeten: Conference paper, data article, comment, postcard, editorial etj.

<sup>4</sup> Revista të dyshimta janë ato në lista të dyshimta, botuesi apo revista, por edhe ato revista që janë në fazë komercializimi: kur indeksimi i abstrakteve në Scopus shumëfishohet në krahasim më një vit më parë. Në raste të tilla granti mbetet në pritje deri në sqarimin e statusit të revistës në Scopus.



**Tabela 1:**

Platforma	Vlera e grantit për autorin e parë		Punime konferenca për vit	Granti i 4-të e tutje (+4)
	Autori i parë	Autor i dytë, korrespondentë		
Scopus (Q1) & WoS: SSCI, SCIE, AHCI	800 €	/	Deri në 3	800 autori i parë
Scopus (Q2)	600 €	/	Deri në 3	600 autori i parë
Scopus (Q3)	400 €	200 €	Deri në 3	400 autori i parë
Scopus (Q4)	300 €	200 €	Deri në 3	/

### **Neni 5**

#### **Mbështetja Financiare për pjesëmarrje në konferenca**

1. Shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca të karakterit shkencore/artistik, kongrese, simpoziume dhe ngjarje artistike ndërkombëtare, mbulohen financiarisht deri në shumën 300 EUR.
2. Pjesëmarrja e stafit të rregullt akademik në aktivitetet e mësipërme duhet të korrespondojë me fushën e tij të specializimit.

### **Neni 6**

#### **Kriteret për përfitim**

1. Kriteret për përfitim të grantit për publikime shkencore janë:
  - 1.1. të jetë staf i rregullt akademik i Kolegjit AAB;
  - 1.2. të dëshmojë publikimin e realizuar përmes emrit të revistës, titullit të punimit dhe linkut të punimit të publikuar;
  - 1.3. të ketë vendosur përkatësinë (affiliation) e punimit *AAB College*, në revistë dhe Scopus/WoS<sup>5</sup>;
  - 1.4. të jetë autor i parë;
2. Kriteret për mbështetje financiare për konferenca janë:
  - 2.1. të dëshmojë miratimin e abstraktit dhe pagesën e tarifës së konferencës (Conference Fee);
  - 2.2. të jetë konferencë ndërkombëtare, duke përjashtuar konferencat rajonale;

<sup>5</sup> Si dhe, punimi t'i indeksohet institucionit.

2.3. të jetë konferencë akademike të organizuara nga institucione arsimore apo kërkimore, duke përjashtuar ato që janë në lista të dyshimta;

3. Dokumentacioni për aplikim duhet të plotësohet sipas formularëve të aprovuar nga Komisioni Qendror për grante dhe mbështetje financiare. Dokumentacioni i pakompletuar i kthehet stafit të rregullt akademik për plotësim.

#### **Neni 7**

#### **Komisioni Qendror për Grante dhe Mbështetje Financiare**

1. Komisioni qendror për grante dhe mbështetje financiare përbëhet nga 3 anëtarë me të drejtë vote si në vijim:

- 1.1. Prorektori për shkencë;
- 1.2. Dekani i Fakultetit përkatës dhe
- 1.3. Prorektori për financa

2. Prorektori për shkencë dhe Prorektori për financa janë anëtarë të përhershëm të komisionit, ndërsa dekani i fakultetit ndërrohet sipas kërkesave që vijnë nga profesorët dhe fusha e tyre e studimit.

3. Vendimet e Komisionit qendror për grante dhe mbështetje financiare merren me shumicë votash.

4. Komisioni në të gjitha rastet duhet t'i përgjigjet kërkesës me miratimin apo refuzimin e saj.

5. Në rastet kur kërkesa refuzohet, atëherë vendimi i komisionit duhet të jetë i arsyetuar.

6. Komisioni qendror obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimi të kërkesës të marrë vendimin përfundimtar, ose nëse i nevojiten informata shtesë për revistën, konferencën shkencore etj, atëherë tridhjetë (30) ditë nga pranimi i informatës së fundit.

7. Vendimet e Komisionit qendror për grante dhe mbështetje financiare janë publike.

8. Lista e përfituesve të granteve publikohet në çdo fundvit.

#### **Neni 8**

Komisioni qendror themelon një bazë të të dhënave në të cilën do të evidentohen të gjitha grantet dhe mbështetjet financiare të aprovuara apo refuzuara.

## **Neni 9**

1. Stafit akademik i pakënaqur me vendimin e Komisionit për grante, ka të drejtë ankesë tek Rektori.
2. Afati i ankesës kundër vendimit të Komisionit për grante është 15 ditë, nga pranimi i vendimit.
3. Rektori formon një Komision për shqyrtimin e ankesave qoftë ad hoc apo për mandat të caktuar.
4. Komisioni i ankesave i themeluar nga Rektori përbëhet nga tre (3) anëtarë nga radhët e stafit akademik të dëshmuar në publikime shkencore.
5. Komisioni i për shqyrtimin e ankesave mund të marrë këto vendime:
  - 5.1. aprovon ankesën dhe ndryshon vendimin e Komisionit për grante;
  - 5.2. aprovon ankesën dhe kthen në rivendosje tek Komisioni për grante;
  - 5.3. aprovon pjesërisht ankesën dhe ndryshon vendimin e Komisionit për grante;
  - 5.4. refuzon ankesën si të pa bazuar;
  - 5.5. refuzon ankesën si të pa afatshme.
6. Vendimi i këtij komisioni është përfundimtar.

## **Dispozitat Kalimtare**

### **Neni 10**


Në rast se dispozitat e kësaj Rregullore bien ndesh me dispozitat e Statutit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

### **Neni 11**

Ndryshimi i kësaj rregullore mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të saj.

### **Neni 12**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Grante Nr. 024/23 e datës 20.01.2023.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga Këshilli Drejtues dhe nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

  
Ilir Tafa,  
Kryetar i Këshillit Drejtues



Prishtinë 2024



# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 869/24 Prishtinë, 24 / 10 / 2024

Në bazë të nenit 16 të Statutit, nenit 4 të Rregullores së Punës të Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues, merr këtë:

## V E N D I M

I. MIRATOHET Rregullorja për Grante.

Një kopje e vendimit:

për: Rektorin  
për: Prorektorët  
për: Sekretarin  
për: Arkivin

  
Ilir Tafa,  
Kryetar i Këshillit Drejtues

